



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 304 Prot.

Tiranë, më 01.02 2018

VENDIM Nr. 24, datë 21.02.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të projektit "*Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve*"- subjekti Bashkia Durrës, në zonë arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit.

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesërisht projektin "*Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve*"- subjekti Bashkia Durrës, në zonë arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, përkatësisht vetëm për rrugën "Aleksandër Goga", në të cilën do të realizohen punime rikualifikimi të asaj ekzistuese, duke lënë për një fazë të mëvonëshme segmentin e rrugës "Fetah Bllaca".
2. Subjekti "Bashkia Durrës" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për pjesën e miratuar të projektit "*Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO